



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
REKTORATI

Nr. 802 Prot.

Gjirokastrë, më 09/06/2023

Lënda: Hapet thirrja për shprehje interesi për aplikim të përbashkët sipas skemës së bursave postdoktorale të veprimeve të BE-së Marie Skłodowska-Curie – Thirrje: MSCA-PF-2023

MSCA MasterClass @UNIVPM është dizenuar kryesisht për aplikantët postdoktoralë Marie Skłodowska-Curie (MSCA-PF) me Universitetin Politeknik të Marche si institucion pritës. MSCA MasterClass ju ofron mundësinë të njiheni me UNIVPM duke përfutur edhe nga një klimë e thelluar për shkrim propozimesh.

Financimi synon studiuesit postdoktoralë që dëshirojnë të fitojnë aftësi të reja përmes trajnimeve të avancuara dhe mundësive për lëvizshmëri ndërkombëtare, ndërdisiplinore dhe ndërsektoriale. Aktiviteti organizohet nga data 4 deri në 7 Korrik (kostot e udhëtimit dhe akomodimit për aplikantët e përzgjedhur do të mbulohen nga institucioni pritës).

Aplikantët duhet të zgjedhin një "projekt propozim të një prej mbikëqyrësve" për të aplikuar dhe të dërgojnë formularët e mëposhtëm:

- CV
- Modeli i Projektit Përfundimtar
- Letër motivimi
- Letër referimi.

Informacion dhe udhëzim për aplikimin mund të gjeni në: <https://mscamasterclass.univpm.it/>

Më poshtë renditen idetë e projekteve të paraqitura nga secili departament dhe nga të gjithë fakultetet:

Fakulteti i Mjekësisë: 10 projekt ide
Fakulteti i Inxhinierisë: 8 projekt ide
Fakulteti i Bujqësisë: 2 projekt ide
Fakulteti Ekonomik: 4 projekt ide
Fakulteti i Shkencave: 3 projekt ide
Ndërsektorial: 5 projekt ide

Afati i aplikimit: **25 qershor 2023**

Prof. dr. Bektash MEMA

REKTOR

